

Rezoluta e 8 e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informacionit nga data 18 deri 20 shtator 2013 në Berlin

Deklarata e Berlinit mbi Përforcimin e Transparencës në Nivel Kombëtar dhe Ndërkombëtar

20 shtator 2013-10-08

“Transparenca: ushqimi i Demokracisë”

Duke pasur parasysh se

- Dëshira e qytetarëve për të ushtruar të drejtat e tyre themelore dhe për të marrë pjesë në procesin politik, është thelbësore për demokracinë,
- Informacioni është një kërkesë e domosdoshme e pjesëmarrjes dhe formimit të opinionit politik,
- Përkueshmëria me kërkesat kushtetuese (sundimi i ligjit), transparenca e aksionit qeveritar dhe një rishikim i fortë gjyqësor legjitimon aksionin qeveritar,
- Transparenca dhe sundimi i ligjit forcojnë besimin tek sjellja në zbatim të ligjit dhe aftësia për të mësuar e funksionarëve e institucioneve federale, rajonale dhe lokale,

Komisionerët e Informacionit të mbledhur në Berlin në Konferencë e 8 Ndërkombëtare vendosin:

Transparenca nuk është e mundur pa akses ligjor të garantuar në informacion. Prandaj, është e nevojshme që të ketë rekomandime ligjore detyruese për informacionin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Të drejtat për informim të garantuara nga ligji ndërkombëtar mbështesin ankesat individuale për akses në informacion nga organizmat ndërkombëtare dhe detyrojnë qeveritë të ndajnë informacionet që kanë me qytetarët e tyre. Veprimet e qeverive dhe të komuniteteve të shteteve, duhet të bazohen në bashkëbisedim dhe pjesëmarrje, edhe më shumë se sa në të shkuarën. Nëse ato duan të realizojnë objektivat e tyre, duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha se sa në të shkuarën, për të fituar besimin e publikut. Demokracia, sundimi i ligjit dhe lufta kundër të këqijave që lidhen me korrupsionin, mund të ndërtohen vetëm aty ku autoritetet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare janë të gatshme to marrin përgjegjësitë për veprimet e tyre dhe të ndajnë informacionin me qytetarët. Në këtë mënyrë, veprimet transparente përbëjnë një armë të fortë në luftën kundër korrupsionit global, i cili lulëzon në një atmosferë sekreti, ku qytetarët janë të ndaluar të marrin pjesë në proceset vendim-marrëse.

Sot, mjaft shtete dhe institucione ndërkombëtare, shpërndajnë tashmë një sërë informacionesh në lidhje me ambientin, aktivitetin parlamentar dhe shumë fusha të tjera. Kjo formë e transparencës forcon vetëbesimin e qytetarëve në punën e tyre. Por gjithsesi ka pengesa të mëdha të cilat duhet të hiqen.

Në parim, edhe vetë shërbimet sekrete nuk mund t'ia refuzojnë publikut të drejtën për transparencë. Saktësisht për arsye se puna e tyre ka të bëjë me ndërhyrjen e thellë në të drejtat themelore të qytetarëve, edhe vetë duhet të jetë objekt mbikëqyrjeje kushtetuese të verifikueshme dhe të kuptueshme për publikun. Të përjashtohet kjo fushë krejtësisht nga e drejta për informim, është papajtueshme me këtë parim. Konferenca bë thirrje sërish për respektim të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të datës 25 qershor 2013 (Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut kundër Serbisë), i cili njuh në parim se e drejta e garantuar për informim në Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, gjen zbatim gjithashtu edhe tek shërbimet sekrete.

Transparenca është gjithashtu e nevojshme aty ku biznesi ndikon vendimet politike dhe administrative, në nivel trans-kombëtar. Veçanërisht në këto raste, garancitë e detyrueshme të transparencës sipas ligjit ndërkombëtar dhe mbikëqyrjes më të madhe ndërkombëtare publike, janë thelbësore me qëllim që të kontrollohet me më shumë efektivitet fuqia e kompanive private. Transparenca është gjithashtu një instrument i rëndësishëm për të luftuar korrupsionin brenda dhe nga ana e kompanive.

Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit

- Mbështet krijimin e detyrimeve të kuptueshme dhe të efektshme të detyrimeve ligjore, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për akses në informacion, sipas kërkesës dhe dhënien e efektshme aktive të informacionit, i cili përfiton nga të gjitha mënyrat e komunikimit, sidomos opsionet që ofrohen nga teknologjia e informacionit;
- Mbështet njohjen e një të drejte themelore ndërkombëtare për informim dhe tërheq vëmendjen tek Neni 19 i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (Civil Covenant, ICCPR) e datës 16 dhjetor 1966, si një konventë ndërkombëtare cila përcakton se çdokush ka të drejtë të ketë opinionet e tij pa ndërhyrje, duke përfshirë lirinë për ta marrë, përfituar dhe shkëmbyer informacion përtej kufijve kombëtarë;
- Pohon sërish mbështetjen e saj, vendosur në Otava në 2011-n, se të gjitha shtetet që plotësojnë kushtet, duhet t'i bashkohen dhe të mbështesin aktivisht Partneritetin e Qeverisjes së Hapur;
- Vëren se Konventa e Këshillit të Evropës mbi Aksesin në Dokumentet Zyrtare të 18 qershorit 2009 (Troms Convention), duke qenë instrumenti i parë ndërkombëtar që parashikon të drejtën e aksesit në informacion tek agjencitë qeveritare, është e hapur për aderim nga të gjitha shtetet e botës dhe rekomandon që të gjitha shtetet të marrin në konsideratë ratifikimin e Konventës.